



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MALLAKASTËR**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 5273 prot.

Ballsh, më 28.10 .2022

**VENDIM**

Nr. 59 , datë 27.10 .2022

**“PËR**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 55, DATË 20.12.2021 “PËR MIRATIMIN E  
NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË MALLAKASTËR,  
INSTITUCIONEVE NË VARËSI, FUNKSIONEVE TË TRANSFERUARA DHE  
DELEGUARA PËR VITIN 2022”**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo –territoriale të njësive të qeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ndryshuar, të ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të VKM-së nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve të administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore, ndryshuar me VKM nr. 625, datë 28.09.2022, të VKM-së nr. 350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, ndryshuar me VKM 624, datë 28.09.2022, të VKM-së nr. 604, datë 14.09.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”,

**VENDOSI:**

1. Në pikën I të Vendimit nr. 55, datë 20.12.2021 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2022”, bëhen këto ndryshime:  
Miratimin e nivelit të pagave të ndryshuara të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, të institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe të deleguara për vitin 2022 sipas lidhjes nr. 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9, pjesë përbërse e këtij projektvendimi.
2. Efektet financiare do të fillojnë nga data 1 shtator 2022 dhe do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Mallakastër.

Ky vendim hyn në fuqi në bazë të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

